

E.E 2019 SHPK

STATUTI

I

SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " E.E 2019 " SHPK

AKTI I THEMELIMIT

Hyrje

Në Tiranë, sot më datë 12/10/2021 unë i nënshkruari Endrin DODA, shtetas shqiptar, i biri I Gjon dhe Marte lindur më 18/12/1975, në Mirdite dhe me banim në adresën rruga Shyqyri Bërxolli nd,31 H3 Ap 16 Tirane, i pajisur me karte Identiteti nr. 032523084 dhe ID H81218051S, madhore me zotësi juridike për të vepruar, në bazë të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, pasi krijova shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"E.E 2019" SH.P.K.** përpiloj këtë statut si më poshtë:

KREU I PARË

Pjesa e përgjithshme

Neni 1

Ortaku I vetëm me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të japë kontributin e tij sipas përcaktimeve që parashikohen në këtë statut për arritjen e objektivave ekonomike duke destinuar në një sipërmarrje pasuri të tij me qëllim që të ndajë fitimin ose që të mund të përfitojnë nga të ardhurat që rrjedhin prej saj.

Neni 2

Emertimi dhe Forma e Shoqërisë

1. Shoqëria tregtare është e organizuar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe mban emërtimin: **" E.E 2019" SHPK**
2. Ajo është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

Neni 3

Periodha e veprimtarisë, përballimi i humbjeve të shoqërisë

1. Shoqëria tregtare **" E.E 2019" SHPK** do të përmbushë objektin veprimtarisë së vet me një afat të pacaktuar kohe. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm, sipas rregullave të parashikuara në këtë statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

E.E 2019 SHPK

Selia, pjesemarrja ne shoqeri te tjera, vula dhe logo

1. Shoqeria tregtare " **E.E 2019** " SHPK ka seline qendrore ne territorin e Republikes se Shqiperise ne qytetin e Tiranës ne adresen: **Rruga Grigor Gjirokastriti ish fusha e aviacionit vila 3-katsh kati-1** Kodi Postar 1023
2. Shoqeria tregtare " **E.E 2019** " SHPK, ka marre masa per te patur nje adrese interneti si dhe nje poste elektronike per komunikim Email: **financatpc@gmail.com**, Nr.tel.**0674050379**. Keto adresa do te jene te vlefshme per te tretet vetem pasi t'i jene njoftuar Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me piken 2 te nenit 69 te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
3. Shoqeria krijon qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjere te Shqiperise ose jashte vendit.
4. Ajo mund te jete pjesemarrrese ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
5. Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendren e vet.
6. Shoqeria do te kete vulen e saj dhe logon e saj. Me Vendim te Ortakut te Vetem, vula e shoqerise dhe logoja mund t'i raportohen Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni5

Personaliteti Juridik

1. Shoqeria tregtare "**E.E 2019**" SHPK, duke qene se eshte e regjistruar prane Regjistrimit Tregtar, gezon personalitet juridik ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një personaliteti juridik të ri.

Neni6

Objekti i Veprimtarise

Shoqeria tregtare " **E.E 2019** " SHPK ka si objekt te veprimtarise se saj:

- **Shërbimin Taksi 4+1 brenda dhe jashtë teritorit të vendit.**

Neni 7

Pergjegjesia e Shoqerise

Shoqëria tregtare "**E.E 2019**" SHPK nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

NENI 8

Kapitali Themeltar, pjesemarrja

1. Shoqeria tregtare "**E.E 2019**" SHPK, ka nje kapital themeltar në vlerën prej 500,000 (Peseqind mije)

E.E 2019 SHPK

Lekë, e cila zotërohet tërësisht nga ortakut I vetëm I shoqërisë dhe e ndarë në 1 (një) kuotë.

2. Pjesëmarrja e ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë :
 - Endrin DODA----500,000(peseqind mije) Leke, perkatesisht 1 (nje) kuote.
3. Ky kapital perbehet nga një kuotë të barabartë me 500,000(peseqind mijë) Lekë.

KREU II

Shpërndarja e fitimeve

Neni 9

Menyra e shperndarjes se fitimeve

1. Ne baze te pjesemarrjes se kapitali themeltar ne shoqeri, fitimi i shperndahet ortakut te vetem ne raport me kuotat e zoteruara. Keto fitime i shperndahen ortakut te veten, vetem nese pas pagimit te dividendit :
 - a) Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
 - b) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve.
2. Ne rast te plotesimit te kushteve te siperpermendura ne kete nen, nga ana e administratorit te shoqerise leshohet nje gertifikate qe tregon aftesine paguese te shoqerise. Ne te kundert nje gertifikate e tille nuk mund te leshohet. Leshimi i nje certifikate te tille ne kundershtrim me kete nen, ngarkon administratorin me pergjegjesi.
3. Te ardhurat neto qe do te rezultojne nga bilanci i miratuar nga ortakët do te shperndahen si vijon :
 - a) 5% per fondin rezerve, deri sa ky fond te arrije 1/5 e kapitalit themeltar;
 - b) pjesa tjeter i shperndahet ortakut të vetëm ne raport me pjesemarrjen e tij ne kapitalin themeltar.

Neni 10

Fondi rezerve

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veganta te financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar. Krijimi i nje fondi te tille, behet gjithmone me vendim te Ortakut të vetëm.

Neni 11

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi i Cdo fondi te vecante percaktohen nga organi perkates sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi <do operacion financiar i saj do te pasqyrohen ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

Neni 12

1. Shoqeria tregtare " **E.E 2019** " SHPK eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ate ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

E.E 2019 SHPK

Neni13

1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim te Ortakut te Vetem.

KREU III

Transferimi i Kapitalit

Neni14

Transferueshmeria e kapitalit

1. Kuotat kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.
2. Personi qe e fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes se ortakut gezon te drejtat e titullarit te cilat do ti kishte ai. Por ama me perjashtim te faktit qe perpara se te realizohet ky regjistrim i kuotes duhet patjeter te behet dorezimi perkates.

Neni 15

Transferimi me ane te trashegimise

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

Neni16

Transferimi i kuotave tek personat e trete

1. Ne rast mospranimi pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin nga Ortaku I vetëm.
2. Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim, prane nje noteri dhe i njoftohet shoqerise.
3. Transferimi i tyre, merr vlere vetem pas regjistrimit te kalimit te kuotave prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

KREU IV

Ndryshimi i kapitalit themeltar

Neni17

1. Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne natyre apo zvogelimi i tij behet me miratimin e Asamblese se Ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar dhe me kerkesen qofte edhe te njerit prej ortakeve themelues.
2. Zvogelimi i kapitalit themeltar, behet ne baze te dispozitave te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

E.E 2019 SHPK

Neni 18 Zmadhimi i Kapitalit

1. Ortakët, mund të vendosin që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashperndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhese. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Ortakët, me vendim të këtyre miratuar llogarite vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhese.
2. Pas marrjes së një vendimi të tillë, Ortakët caktojnë një Ekspert Kontabel të Regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
3. Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga Eksperti Kontabel i Regjistruar, ortakët e shoqërisë, me një vendim tjetër, përcaktojnë mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Pas marrjes së vendimit të dytë nga Ortakët, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

KREU V Ortakëria

Neni 19

Ortakëria për shoqëri tregtare "E.E 2019" SHPK krijohet dhe mbështetet në Statutin e kësaj shoqërie dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 20

Shoqëria Tregtare "E.E 2019" SHPK, ka vetëm një ortak, të drejtat dhe detyrimet e të cilit përcaktohen në këtë statut dhe në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 21

Ortakët e shoqërisë tregtare "E.E 2019" SHPK gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, dhe në Statutin e shoqërisë.

Neni 22

- Të drejtat dhe detyrat e ortakëve;
- Të marrë pjesë në mbledhjet e Ortakut të vetëm;
- Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
- Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, e raportin e ekspertit kontabel;
- Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
- Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

KREU VI Organizimi i shoqërisë

E.E 2019 SHPK

Neni 23

Strukturat Drejtuese dhe Vendimmarrese

Shoqeria tregtare " E.E 2019 " SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendim marrese :

Ortakët si organi vendimmarres per shoqerine dhe
Administratorin

Neni 24

Detyrat dhe Pergjegjesite e Organit Vendimmarres

1. Ortakët, si organ vendimmarres per shoqerine, janë pergjegjes per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç;" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ç;eshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Ortakët marrin vendime per ceshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "e" te pikes "1" te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.

3. Te gjitha vendimet e marra nga ortakët do te regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Forma e regjistrimit dhe mbajtja e vendimeve percaktohen me vendim te ortakut të vetëm. Ortakët, me vendim, mund te ngarkoje dhe nje person fizik per mirembajtjen e regjistrimit te mbledhjeve.

4. Nga ana e Ortakut të vetëm merren te gjitha masat perkatese per regjistrimin e vendimeve te saj prane organeve perkatese shteterore dhe sidomos ne vecanti, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç;) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- d) vendimet e marra ne zbatim te nenit 18 te ketij statuti.

5. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.

Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

E.E 2019 SHPK

Neni25

Mbledhja e Organit Vendimmarres

1. Mbledhja e Ortakut të vetëm zhvillohet ne rastet e percaktuara nga Ligji Nr. 9904 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", nga ligje te tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e ortakut te vetem thirret dhe zhvillohet te pakten nje here ne vit.
2. Mbledhja e Ortakut të vetëm thirret nga kryesisht nga ortakët , administratori apo dhe nga Eksperti Kontabel i Regjistruar kur ka nevoje per diskutime per ceshtje ekonomike qe lidhen me shoqerine.
3. Mbledhja e Ortakut të vetëm thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 (tre) muajve ne vazhdim.
4. Mbledhja e Ortakut të vetëm thirret nga personat e tjere te parashikuar nga pika 2 e ketij neni jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar ne mbledhjen e Ortakut të vetëm. Menyra e thirrjes se Asamblese behet sipas percaktimeve perkatese te parashikuara ne nenin 83 te Ligjit Nr. 9904 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni26

Administrimi, Detyrat e Administratorit

1. Administrimi i shoqerise " **E.E 2019** " SHPK kryhet nga Administratori.
Administratori mund te jete person dhe person fizik jashte shoqerise.
2. Administrator i shoqerise i emeruar do te jete z.**Endrin DODA**, shtetas shqiptar, i biri I Gjon dhe Marte lindur më 18/12/1975, në Mirdite dhe me banim në adresën rruga Shyqyri Bërxolli nd,31 H3 Ap 16 Tirane, i pajisur me karte Identiteti nr. 032523084 dhe ID H81218051S madhor me zotesi juridike per te vepruar, me nje mandat **pesëvjecar, nga data 12 Tetor 2021 deri me 11 Tetor 2026**
3. Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:
 - a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
 - b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
 - c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
 - 9) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara Ortakut të vetëm per miratim;
 - d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
 - dh) kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si9 parashikohet ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
 - e) raportoje perpara Ortakut të vetëm ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
 - e)perfaqesoje shoqerine ne marredhenie mete tretet;
 - f)kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni27

E.E 2019 SHPK

Pergjegjesia e Administratorit

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Neni 28

Eksperti Kontabil i Regjistruar

1. Shoqeria Tregtare " **E.E 2019** " SHPK emeron Ekspert Kontabel te Regjistruar.
2. Emerimi kryhet nga Ortakët.
3. Per kompetencat, detyrimet, pergjegjesite, zevendesueshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 29

Punesimi ne Shoqeri

Te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet mbi bazen e kontrates individuale apo kolektive, sipas rastit, ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne kete fushe.

KREU VII

Bashkimi dhe ndarja e shoqerise

Neni 30

1. Shoqeria " **E.E 2019** " SHPK me ane te bashkimit mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ato themelojne qe ushtron te njejtin aktivitet.
2. Gjithashtu shoqeria " **E.E 2019** " SHPK me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.
3. Ne rast se operacioni perfshin krijimin e shoqerive te reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave qe i perkasin shoqerise qe do te krijohet.
4. Transferimi i plote i aktivitet te shoqerise apo kontributi ne aktiv te nje shoqerie tjeter, ver;anerisht me ane te procesit te bashkimit duhet te autorizohet nga Ortakët

KREU VIII

Prishja dhe likuidimi i shoqerise

Neni 31

1. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkaku, si ne rast falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortakët.
2. Shoqeria hyn ne fazen e likuidimit qysh ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Ortakët emerojnë nje ose disa likuidatore, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e

E.E 2019 SHPK

aktivitet dhe pasivitet të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të perfundimit të tyre. Shoqëria priset në këto raste: Kur nuk mund të përmbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria

- Me vullnetin e ortakëve
- Me vendim të Gjykatës
- Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

Neni 32 Procedura që ndiqen

1. Likuidimi i shoqërisë tregtare "E.E 2019" SHPK vendoset nga Ortakët kur priset shoqëria.
2. Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në nenet 192 -203 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni33

1. Në qoftë se Ortakët, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrin vendim ose ata nuk pranojnë të miratojnë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
2. Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Ortakut të vetëm zbaton dispozitatë ligjore dhe nëse miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.

Neni 34

Në fund të procesit të likuidimit thirren Ortakët për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.

KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

1. Të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen me anë të dispozitave të këtij statuti.
2. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohet Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni36

Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjten vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

ENDRIN DODA

